

VENDIM
Nr.761,datë 6.12.2005

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE “UNIVERSITETI “KRISTAL””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””.
2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal””, me seli qendrore në Tiranë (Mëzez, komuna Kashar), do të ketë tri fakultete:
 - Fakultetin e Administrimit të Biznesit;
 - Fakultetin e Drejtësisë;
 - Fakultetin e Farmacisë dhe të Stomatologjisë.
3. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti “Kristal”” do të japë:
 - a) Në Fakultetin e Administrimit të Biznesit, diplomë universitare në këto degë:
 - Financë (3 vite akademike);
 - Menaxhim biznesi (3 vite akademike).
 - b) Në Fakultetin e Drejtësisë, diplomë universitare në këtë degë:
 - Juridik (3 vite akademike).
 - c) Në Fakultetin e Farmacisë dhe të Stomatologjisë, diplomë universitare në këto degë:
 - Farmaci (3 vite akademike);
 - Stomatologji (5 vite akademike).
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të kryejë procesin e vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit dhe zbatimin e ligjshmërisë.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha